



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE



BULETINI I PRONËSISË INDUSTRIALE (Patenta)

Nr. 08/2023

Tiranë më, 06 Mars 2023

| | |
|--|-----------|
| Kodet e përdorura në gazette..... | 3 |
| INID Codes used in gazette | |
| Kodet e shteteve..... | 4 |
| States codes | |
| Patenta të lëshuara..... | 9 |
| Granted Patents | |
| Korrigjime(Transferim i pronësisë)..... | 54 |
| Corrections (Change of Ownership) | |
| Korrigjime(Aplikim per SPC)..... | 56 |
| Corrections (SPC renewal) | |
| Korrigjime(SPC)..... | 58 |
| Corrections (SPC) | |
| Aplikime kombëtare për patentë..... | 60 |
| Patent National Applications | |

Kodet INID dhe minimumi i kërkuar për identifikimin e të dhënave bibliografike lidhur me:

Patentat.

- (11) Numri i patentës
- (21) Numri kombëtar i aplikimit
- (22) Data e depozitimit në Shqipëri
- (30) Prioriteti
- (54) Titulli i shpikjes
- (57) Pretendimet
- (71) Emri dhe adresa e aplikuesit
- (72) Emri/ Adresa e Shpikësit
- (73) Emri dhe adresa dhe pronarit të patentës
- (92) Numri dhe data e autorizimit të hedhjes së produktit në treg
- (95) Produkti i identifikuar në autorizimin e hedhjes së tij në treg
- (96) Numri dhe data ndërkombëtare e aplikimit
- (97) Numri dhe data Nderkombëtare e publikimit

Kodet e shteteve

| | |
|---|----|
| Afghanistan / Afganistani | AF |
| Albania / Shqipëria | AL |
| Algeria / Algjeria | DZ |
| Angola / Anguila | AI |
| Antigua and Barbuda / Antigua dhe Barbud | AG |
| Argentina / Argjentina | AR |
| Aruba / Aruba | AW |
| Australia / Australia | AU |
| Austria / Austria | AT |
| Bahamas / Bahamas | BS |
| Bahrain / Bahrein | BH |
| Bangladesh / Bangladeshi | BD |
| Barbados / Barbados | BB |
| Belarus / Bjellorusia | BY |
| Belgium / Belgjika | BE |
| Belize / Belice | BZ |
| Benin / Benin | BJ |
| Bermuda / Bermuda | BM |
| Bhutan / Bhutan | BT |
| Bolivia / Bolivia | BO |
| Bosnia Herzegovina / Bosnja Hercegovina | BA |
| Botswana / Botsvana | BW |
| Bouvet Islands / Ishujt Buver | BV |
| Brazil / Brazili | BR |
| Brunei Darussalam/Brunei Darusalem | BN |
| Bulgaria / Bullgaria | BG |
| Burkina Faso / Burkina Faso | BF |
| Burma / Burma | MM |
| Burundi / Burundi | BI |
| Cambodia / Kamboxhia | KH |
| Cameroon / Kameruni | CM |
| Canada / Kanada | CA |
| Cape Verde / Kepi i Gjëlber | CV |
| Cayman Islands / Ishujt Kaiman | KY |
| Central African Republic / Republika e Afrikës Qendrore | CF |
| Chad/ Cadi | TD |
| Chile / Kili | CL |
| China / Kina | CN |
| Colombia / Kolumbia | CO |
| Comoros / Komoros | KM |
| Congo / Kongo | CG |
| Cook Islands / Ishujt Kuk | |
| Costa Rica / Kosta Rika | CR |
| Cote d'Ivoire / Bregu I Fildishte | CI |
| Croatia / Kroacia | HR |
| Cuba / Kuba | CU |
| Cyprus / Qipro | CY |
| Czech Republic / Republika Çeke | CZ |

| | |
|---|----|
| Denmark / Danimarka | DK |
| Djibouti / Xhibuti | DJ |
| Dominika / Domenika | DM |
| Dominican Republic / Republika Domenikane | DO |
| Ecuador / Ekuadori | EC |
| Egypt / Egjipti | EG |
| El Salvador / El Salvadori | SV |
| Equatorial Guinea / Guinea Ekuatoriale | GQ |
| Erintrea / Erintrea | ER |
| Estonia / Estonia | EE |
| Ethiopia / Etiopia | ET |
| Falkland Islans / Ishujt Malvine | FK |
| Fiji / Fixhi | FJ |
| Findland / Findland | FI |
| France / Franca | FR |
| Gabon / Gaboni | GA |
| Gambia / Gambia | GM |
| Georgia / Gjeorgjia | GE |
| Germany / Gjermania | DE |
| Ghana / Gana | GH |
| Gibllartar / Gjibraltari | GI |
| Greece / Greqia | GR |
| Grenada / Granada | GD |
| Guatemala / Guatemala | GT |
| Guinea / Guinea | GN |
| Guinea Bissau / Guinea Bisao | GW |
| Guyana / Guajana | GY |
| Haiti / Haiti | HT |
| Honduras / Hondurasi | HN |
| Hong Kong / Hong Kongu | HK |
| Hungary / Hungaria | HU |
| Iceland / Islanda | IS |
| India / India | IN |
| Indonezia / Indonezia | ID |
| Iran / Irani | IR |
| Iraq / Iraku | IQ |
| Ireland / Irlanda | IE |
| Israel / Israeli | IL |
| Italy / Italia | IT |
| Jamaica / Xhamaika | JM |
| Japan / Japonia | JP |
| Jordan / Jordania | JO |
| Kazakhstan / Kazakistani | KZ |
| Kenya / Kenia | KE |
| Kiribati / Kiribati | KI |
| Korea / Korea | KR |
| Kyrgyzstan / Kirgistan | KG |
| Kwait / Kuvaiti | KW |
| Laos / Laosi | LA |
| Latvia / Letonia | LV |
| Lebanon / Libani | LB |

| | |
|---|----|
| Lesotho / Lesoto | LS |
| Liberia / Liberia | LR |
| Macau / Makau | MO |
| Madagascar / Madagaskari | MG |
| Malawi / Malavi | MW |
| Malaysia / Malaizia | MY |
| Maldives / Maldives | MV |
| Mali / Mali | ML |
| Malta / Malta | MT |
| Marshall Islands / Ishujt Marshall | MH |
| Mauritania / Mauritania | MR |
| Mauritius / Mauritius | MU |
| Mexico / Meksika | MX |
| Monaco / Monako | MC |
| Mongalia / Mongolia | MN |
| Montserrat / Montserrati | MS |
| Morocco / Maroku | MA |
| Mozambique / Mozambiku | MZ |
| Myanmar / Myanmar | MM |
| Namibia / Namibia | NA |
| Nauru / Nauru | NR |
| Nepal / Nepal | NP |
| Netherlands / Hollanda | NL |
| Netherlands Andilles /Antilet Hollandeze | AN |
| New Zealand / Zelanda e Re | NZ |
| Nicaragua / Nikaragua | NI |
| Niger / Nigeri | NE |
| Nigeria / Nigeria | NG |
| Norway / Norvegjia | NO |
| Oman / Omani | OM |
| Pakistan / Pakistani | PK |
| Palau / Palau | PW |
| Panama / Panamaja | PA |
| Papua New Guinea / Papua Guinea e Re | PG |
| Paraguay / Paraguai | PY |
| Peru / Peruja | PE |
| Philippines / Filipine | PH |
| Poland / Polonia | PL |
| Portugal / Portugalia | PT |
| Qatar / Katari | QA |
| Republik Of Moldova / Republika e Moldavise | MD |
| Romania / Rumania | RO |
| Russian Federation/Federata Ruse | RU |
| Rwanda / Ruanda | RW |
| Saint Helena / Shen Helena | SH |
| Saint Kitts and Nevis / Shen Kits dhe Nevis | KN |
| Saint Lucia / Shen Lucia | LC |
| Saint Vincent and the Grenadines / Shen Vinsenti dhe Grenadinet | VC |
| Samoa / Samoa | WS |
| San Marino / San Marino | SM |
| Sao Tome and Principe /Sao Tome dhe Principe | ST |

| | |
|--|----|
| Saudi Arabia / Arabia Saudite | SA |
| Senagal / Senegali | SN |
| Seychelles / Sejshellet | SC |
| Sierra Leone / Sierra Leone | SL |
| Singapore / Singapori | SG |
| Slovakia / Sllovakia | SK |
| Slovenia / Sllovenia | SI |
| Solomon Islans / Ishujt Solomone | SB |
| Somalia / Somalia | SO |
| South Africa / Afrika e Jugut | ZA |
| Spain / Spanja | ES |
| Sri Lanka / Sri Lanka | LK |
| Sudan / Sudani | SD |
| Suriname / Surinami | SR |
| Swaziland / Shvacilandi | SZ |
| Sweden / Suedia | SE |
| Switzerland / Zvicra | CH |
| Syria / Siria | SY |
| Taiwan / Taivani | TW |
| Thailand / Tailanda | TH |
| Togo / Togo | TG |
| Tonga / Tonga | TO |
| Trinidad and Tobago / Trinidad dhe Tobako | TT |
| Tinisia / Tunizia | TN |
| Turkey / Turqia | TR |
| Turkmenistan / Turkmenistani | TM |
| Turks and Caicis Islands / Ishujt Turk dhe Kaiko | TC |
| Tuvalu / Tuvalu | TV |
| Uganda / Uganda | UG |
| Ukraine / Ukraina | UA |
| United Arab Emirates /Emiratet e Bashkuara Arabe | AE |
| United Kingdom/ Mbreteria e Bashkuar | GB |
| United Republic of Tanzania / Republika e Bashkuar e Tanzanise | TZ |
| United States of America / Shtetet e Bashkuara te Amerikes | US |
| Uruguay / Uruguai | UY |
| Uzbekistan / Uzbekistani | UZ |
| Vanuatu / Vanuatu | VU |
| Vatican / Vatikani | VA |
| Venezuela / Venezuela | VE |
| Vietnam / Vietnami | VN |
| Virgin Islands / Ishujt Virxhin | VG |
| Yemen / Jemeni | YE |
| Yugoslavia / Jugosllavia | YU |
| Zaire / Zaireja | ZR |
| Zambia / Zambia | ZM |
| Zimbabwe / Zimbabve | ZW |

PATENTA TË LËSHUARA

(11) **11249**

(97) EP3906970 / 06/07/2022

(96) 20173670.9 / 08/05/2020

(22) 19/09/2022

(21) AL/P/ 2022/464

(54) **PARAPOKSVIRUS PER KONDICIONIMIN DHE TRAJTIMIN E INFEKSIONEVE TE KORONAVIRUSIT**

01/03/2023

(30)

(71) AiCuris GmbH & Co. KG

Friedrich-Ebert-Strasse 475, 42117 Wuppertal, DE

(72) BIRKMANN, Alexander (, 42327 Wuppertal); PAULSEN, Daniela (, 1272 GN Huizen); LISCHKA, Peter (, 40477 Düsseldorf); PFAFF, Tamara (, 40468 Düsseldorf); ZIMMERMANN, Holger (, 42113 Wuppertal)

(74) Vladimir Nika

Rr. Fadil Rada Pall. Gener 2, Shk. C, Nr. 2/1, Tiranë

(57)

1. Një agjent Parapoxvirus ovis (PPVO) për përdorim në (i) përgatitjen e një subjekti për një infeksion koronavirus ose (ii) trajtimin e një infeksioni koronavirus në një subjekt.

2. Agjent PPVO për përdorim sipas pretendimit 1, ku agjenti PPVO është:

(a) vetë PPVO ose një fragment i tij, ose

(b) një agjent që përmban informacion gjenetik që kodon për (a).

3. Agjent PPVO sipas pretendimit 2, ku agjenti PPVO është një virion PPVO i pa aktivizuar.

4. Agjent PPVO për përdorim sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 3, ku koronavirusi është një koronavirus SARS.

5. Agjent PPVO për përdorim sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 4, ku koronavirusi është SARS-CoV-2 ose një variant i tij me të paktën 80% identitet sekuece me NR ID SEK: 1 ose 2.

6. Agjent PPVO për përdorim sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 5, ku subjekti që do të përgatitet karakterizohet nga një ose më shumë faktorë rreziku për kontraktimin e një infeksioni koronavirus dhe/ose nga një ose më shumë faktorë rreziku për të patur një ecuri të rëndë të sëmundjes koronavirus.

7. Agjent PPVO për përdorim sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 5, ku subjekti që do të trajtohet është asimptomatik.

8. Agjent PPVO për përdorim sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 5, ku subjekti që do të trajtohet ka sëmundje koronavirus, mundësisht Covid-19.

9. Agjent PPVO për përdorim sipas pretendimit 8, ku subjekti ose nuk ka simptoma të rënda, ose ka një ecuri të rëndë të sëmundjes koronavirus.

10. Agjent PPVO për përdorim sipas secilit prej pretendimeve 1 deri në 9, ku përdorimi përfshin administrimin e një regjimi të mëtejshëm trajtimi për (i) ose (ii).

11. Agjent PPVO për përdorim sipas pretendimit 10, ku regjimi i mëtejshëm i trajtimit për (i) përfshin administrimin e një agjenti koronavirus dhe/ose një agjenti stimulues imun, dhe regjimi i mëtejshëm i trajtimit për (ii) përfshin administrimin e një agjenti të virusit korona, një ose më shumë medikamente të tjera dhe/ose një ose më shumë trajtime të mëtejshme pa ilaçe.

12. Agjent PPVO për përdorim sipas pretendimit 11, ku

- Agjenti i koronavirusit zgjidhet nga grupi i përbërë nga:

- (i) një koronavirus i pa aktivizuar,
- (ii) një fragment antigjenik, mundësisht imunogjenik i një koronavirusi,
- (iii) një acid nukleik që kodon për (i) ose (ii)
- (iv) një vektor që përfshin acidin nukleik të (iii),
- (v) një qelizë që përmban acidin nukleik të (iii) ose vektorin e (iv),
- (vi) një antitруп ose një fragment i tij që lidh antigjenin që lidhet me një koronavirus ose një fragment të tij, mundësisht mbështjellësen,
- (vii) një analog nukleotid/nukleozid, mundësisht specifik për koronavirusin,
- (viii) një molekulë ARNi specifike për koronavirusin,
- (ix) një molekulë e vogël, një antitруп ose një fragment që lidhet me antigjenin i tij, që lidhet me një vend të ndërveprimit proteinë-proteinë (PPI) midis një proteine të koronavirusit dhe një proteine subjekti, dhe
- (x) plazma e gjakut e një subjekti që është shëruar nga një infeksion koronavirus, mundësisht nga sëmundja koronavirus;

- medikamenti i mëtejshëm zgjidhet nga grupi që përbëhet nga një agjent stimulues imun, një antiviral, një antibiotik, një ndihmës, një glukokortikoid, një ilaç antihipertensiv, një ilaç hipoglikemik, një ilaç kundër goditjes dhe një ilaç i përshtatshëm për trajtimin e një ose më shumë simptomave të sëmundjes së koronavirusit; dhe/ose

- një ose më shumë terapi të tjera që preferohet të zgjidhen nga grupi që përbëhet nga terapia me oksigjen dhe mbështetja e organeve ekstra-korporale (ECOS).

13. Agjent PPVO për përdorim sipas pretendimit 12, ku molekula e vogël zgjidhet nga grupi i përbërë nga Loratadin, Daunorubicin, Midostaurin, Ponatinib, Silmitasertib, Acidi Valproik, Haloperidol, Metformin, Migalastat, S-verapamil, Indometacin, Ruksolitinib, Mikofenelik, Entakapon, Ribavirin, E-52862, Merimepodib, RVX- 208, XL413, AC-55541, Apicidin, AZ3451, AZ8838, Bafilomicin A1, CCT 365623, GB110, H-89, JQ1, PB28, PD-144418, RS-PPCC, TMCB, UCPH-101, ZINC1775962367, ZINC4326719, ZINC4511851, ZINC95559591, 4E2RCat, ABBV-744, Kamostat, Kaptopril, CB5083, Kloramfenikol, Klorokinë, Komponimi 10 i frenuesit PI4K-III β , Komponimi 2 i frenuesit të Ciklofilinës, CPI-0610, Dabrafenib, DbeQ, dBET6, IHVR-19029, Linezolid, Lisinopril, Minoksidil, ML240, MZ1, Nafamostat, Pevonedistat, PS3061, Rapamicin (Sirolimus), Sanglifehrin A, Sapanisertib (INK128/MIN128), FK-506 (Takrolimus), Ternatin 4 (DA3), Tigecikline, Tomivosertib (eFT-508), Verdineksor, WDB002, Azacitidine, Selineksor, dhe Zotatifin (eFT226).

14. Një përbërje ose një komplet që përmban një agjent PPVO, mundësisht siç përcaktohet në pretendimin 2 ose 3, dhe një agjent koronavirus, mundësisht siç përcaktohet në pretendimin 12.

15. Një përbërje ose komplet farmaceutik për përdorim në (i) përgatitjen e një subjekti për një infeksion koronavirus ose (ii) trajtimin e një infeksioni nga virusi Corona në një subjekt, ku përbërja ose kompleti farmaceutik përmban një agjent PPVO, mundësisht siç përcaktohet në pretendim 2 ose 3, dhe mundësisht një medikament tjetër, më mirë siç përcaktohet në pretendimin 12.

(11) **11250**

(97) EP3691620 / 27/07/2022

(96) 18792812.2 / 05/10/2018

(22) 19/09/2022

(21) AL/P/ 2022/465

(54) FRENUESIT E KINAZËS P38 ZVOGËLOJNË SHPREHJEN E GJENIT DUX4 NË DREJTIM TË TRANSKRIPTIMIT PËR TRAJTIMIN E FSHD

01/03/2023

(30) 201762568673 P 05/10/2017 US; 201762568754 P 05/10/2017 US; 201862682563 P 08/06/2018 US and 201862682565 P 08/06/2018 US

(71) Fulcrum Therapeutics, Inc.

26 Landsdowne Street, Cambridge, Massachusetts 02139, US


(72) CACACE, Angela Marie (143 Injun Hollow Road, Haddam Neck, Connecticut 06424); ROJAS SOTO, Luis Gustavo Alejandro (150 Cambridge Street Apt. 409, Cambridge, Massachusetts 02141); THOMPSON, Lorin A., III (20 Short Street, Cohasset, Massachusetts 02025); WALLACE, Owen Brendan (160 Salisbury Road, Brookline, Massachusetts 02445); RONCO, Lucienne V. (16 Garden Road, Wellesley, Massachusetts 02481); CHANG, Aaron Nakwon (41 Preston Road, Lexington, Massachusetts 02420); SHEN, Ning (82 Hancock Street, Apt. 1, Cambridge, Massachusetts 02139); ROBERTSON, Alan Scott (160 Cambridgepark Drive, Apt. 278, Cambridge, Massachusetts 02139)

(74) Krenar Loloçi

Rr. Ibrahim Rugova, P. 1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri

(57)

1. Një frenues i kinazës p38 për përdorim në një metodë të trajtimit të distrofisë muskulare facioskapulohumerale (FSHD), metodë që përfshin administrimin e një sasive efektive të frenuesit të kinazës p38 te një subjekt që ka nevojë për të, ku frenuesi i kinazës p38 është karakterizuar nga Formula (V'):



ose një kripë e saj farmaceutiki:

2. Një frenues i kinazës p38 për përdorim i përcaktuar në formulën (V'), kinazës p38 ose kripa e tij farmaceutikisht e pranueshme është administruar te subjekti në kombinim me një agjent tjetër farmaceutik për trajtimin e FSHD.

3. Frenuesi i kinazës p38 për përdorim i çdonjërit prej pretendimeve 1-2, ku frenuesi i kinazës p38 zvogëlon nivelet e shprehjes DUX4 dhe/ose shprehjen e një ose më shumë gjeneve në drejtim të transkriptimit në qelizat muskulore të subjektit.

4. Frenuesi i kinazës p38 për përdorim i pretendimit 3, ku gjeni DUX4 në drejtim të transkriptimit është zgjedhur nga grupi i përbërë nga: ZSCAN4, LEUTX, PRAMEF2, TRIM43, MBD3L2, KHDC1L, RFPL2, CCNA1, SLC34A2, TPRX1, PRAMEF20, TRIM49, PRAMEF4, PRAME6, PRAMEF15 dhe ZNF280A.

5. Frenuesi i kinazës p38 për përdorim sipas çdonjërit prej pretendimeve 1-4, ku qelizat muskulore:

- (a) janë qeliza muskulore të diferencuara përfundimisht,
 - (b) përfshijnë një grup të çrregulluar D4Z4 në kromozomin 4q35, ku në mënyrë opsionale grupi D4Z4 përfshin më pak se 11 njësi përsëritëse, ose
 - (c) përfshijnë të paktën një alel 4qA jo të fshirë;
- me kusht që, kur qelizat muskulore të përfshijnë të paktën një alel 4qA jo të fshirë, qelizat muskulore të përfshijnë një ose më shumë mutacione në një në një Domen të Varur Fleksibël të Mirëmbajtjes të Kromozomeve Strukturor që Përmban 1 gjen (SMCHD1).

6. Frenuesi i kinazës p38 për përdorim i çdonjërit prej pretendimeve 1-5, ku distrofia muskulare facioskapulohumerale është

(a) FSHD tip 1 (FSHD1), në mënyrë opsionale ku qelizat e muskujve përfshijnë një fshirje të një ose më shumë përsëritjeve makrosatelitore D4Z4 në rajonin subtelomerik të kromozomit 4q35, më tej në mënyrë opsionale ≤ 7 përsëritje makrosatelitore D4Z4 në rajonin subtelomerik të kromozomit 4q35, ose

(b) FSHD tipi 2 (FSHD2), ku në mënyrë opsionale qelizat muskulore përfshijnë një ose më shumë mutacione në një Domen të Varur Fleksibël të Mirëmbajtjes të Kromozomeve Strukturor që Përmban 1 gjen (SMCHD1).

7. Frenuesi i kinazës p38 për përdorim sipas çdonjërit prej pretendimeve 1-6, ku administrimi shkakton një ulje të degjenerimit të muskujve në subjekt.

8. Frenuesi i kinazës p38 për përdorim i çdonjërit prej pretendimeve 1-7, ku administrimi shkakton një reduktim të apoptozës të qelizave muskulore në subjekt.

9. Frenuesi i kinazës p38 për përdorim i çdonjërit prej pretendimeve 1-8, ku frenuesi i kinazës p38 ose kripa e tij farmaceutikisht e pranueshme është administruar te subjekti në mënyrë parenterale.

10. Frenuesi i kinazës p38 për përdorim i çdonjërit prej pretendimeve 1-8, ku frenuesi i kinazës p38 ose kripa e tij farmaceutikisht e pranueshme është administruar te subjekti në mënyrë orale.

11. Frenuesi i kinazës p38 për përdorimin i pretendimit 10, ku frenuesi i kinazës p38 ose kripa e tij farmaceutikisht e pranueshme është administruar në një dozë prej 7.5 mg ose 15 mg dy herë në ditë.

12. Frenuesi i kinazës p38 për përdorimin i pretendimit 11, ku frenuesi i kinazës p38 ose kripa e tij farmaceutikisht e pranueshme është administruar në një dozë prej 7.5 mg dy herë në ditë.

13. Frenuesi i kinazës p38 për përdorim i pretendimit 11, ku frenuesi i kinazës p38 ose kripa e tij farmaceutikisht e pranueshme është administruar në një dozë prej 15 mg dy herë në ditë.

14. Frenuesi i kinazës p38 për përdorim sipas çdonjërit prej pretendimeve 1-8, ku frenuesi i kinazës p38 ose kripa e tij farmaceutikisht e pranueshme është administruar te subjekti nëpërmjet inhalimit.

(11) **11251**

(97) EP3568560 / 22/06/2022

(96) 18708467.8 / 15/01/2018

(22) 20/09/2022

(21) AL/P/ 2022/472

(54) **KOMBINIM GJYSMË I PADUKSHËM PËR DYER RRËSHQITËSE QË LEJON KALIMIN PA PENGESË**

01/03/2023

(30) 20170100009 13/01/2017 GR

(71) Orama Minimal Frames Ltd

Germanikos Dromos, 20 300 Loutraki Attikis, GR

(72) TSIMBIKOS, Georgios (Terma Tinou, 20 300 Loutraki Attikis)

(74) KRENAR LOLOÇI

Rr. "Ibrahim Rugova", Pall. 1/1, Kati 2, Tiranë, Shqipëri

(57)

1. Një kombinim gjysmë i padukshëm i profileve termoizoluese të pjesës së poshtme të dyerve dhe dritareve rrëshqitëse që lejon kalimin e papenguar të njerëzve dhe objekteve mbi të, që përfshin:

- a) të paktën një profil termoizolues i cili quhet kornizë (1) dhe është përshtatur për t'u lidhur fort me komponentët strukturorë të një ndërtese;
- b) të paktën një profil termoizolues i cili quhet brez (3) i cili është i pajisur me një kanal të përshtatshëm në formë U (18) në mënyrë që të jetë në gjendje të marrë një panel izolues termik ose xham (19); dhe
- c) të paktën një profil termoizolues tubular i cili quhet mbështetje horizontale e shtuar (2);
ku, në gjendjen e montuar, mbështetësja horizontale e shtuar (2) dhe brezi (3) lidhen nëpërmjet projeksioneve (26b, 15a, 15b) dhe zgavrave (26a, 16a, 16b) përkatësisht pasi presioni është aplikuar në mënyrë gjatësore në profilet në formë Π (4a, 4b; 4c, 4d);
ku, në gjendjen e montuar, brezi i përmendur (3) dhe një pjesë e sipërme e mbështetjes së shtuar horizontale (2) shtrihen në një pjesë të dukshme mbi dysheme,
ku, në gjendjen e montuar, mbështetja e shtuar horizontale (2) dhe brezi i përmendur (3) rrëshqasin në një brazdë lëvizëse (34) të kornizës (1) dhe
ku, në gjendjen e montuar, korniza në fjalë (1) dhe një pjesë e poshtme e mbështetjes horizontale të shtuar (2) janë poshtë dyshemesë, karakterizuar në atë që brezi (3) është bërë nga PVC ose poliamidi i përforcuar dhe mbështetja e shtuar horizontale (2) është bërë nga poliamidi ose poliesteri, poliamidi ose poliesteri i përmendur që përfshin ose jo tekstil me fije qelqi dhe prodhohet me metodën e pultrusionit.

2. Kombinimi gjysmë i padukshëm i profileve termoizoluese të pjesës së poshtme të dyerve dhe dritareve rrëshqitëse sipas pretendimit 1, ku gjerësia (C) e pjesës së mesme të mbështetjes së shtuar horizontale (2) është më e vogël se gjerësia (E) e pjesët e mbështetjes horizontale të shtuar të cilat janë sipër dhe poshtë dyshemesë.

3. Kombinimi gjysmë i padukshëm i profileve termoizoluese të pjesës së poshtme të dyerve dhe dritareve rrëshqitëse sipas pretendimit 1, ku profilet mbështetëse (7a, 7b) nga njëra ose të dyja anët, janë të vidhosura ose të thumba në kornizë (1) për të arritur shtrirjen, bashkëplanariteti, mbështetja dhe shtrirja e komponentëve strukturorë (12a, 12b, 12c; 12d, 12e, 12f) të brendshme dhe të jashtme të dyshemesë tangjenciale nëpërmjet profileve mbështetëse të aluminit (8a, 8b, 8c; 8d, 8e, 8f) të vendosura në marrës (14a, 14b).

4. Kombinimi gjysmë i padukshëm i profileve termoizoluese të pjesës së poshtme të dyerve dhe dritareve rrëshqitëse sipas pretendimit 1, ku një zonë termoizoluese (27) është një zgjatim vertikal i panelit termoizolues ose xhamit (19) dhe kufijve të zonës termoizoluese (27) janë të përqendruara me një bosht vertikal të mesit (31).

5. Kombinimi gjysmë i padukshëm i profileve termoizoluese të pjesës së poshtme të dyerve dhe dritareve rrëshqitëse sipas pretendimit 1, ku lidhja midis mbështetjes së shtuar horizontale (2) dhe brezit (3) lejon që profilet e përmendura të rrëshqasin ndërmjet tyre për shkak të tkurrje dhe zgjerim gjatësor në bosht.

6. Kombinimi gjysmë i padukshëm i profileve termoizoluese të pjesës së poshtme të dyerve dhe dritareve rrëshqitëse sipas pretendimit 1, ku pjesa e dukshme mbi dysheme ka një dimension (B) më të vogël se 22 mm.

7. Kombinimi gjysmë i padukshëm i profileve termoizoluese të pjesës së poshtme të dyerve dhe dritareve rrëshqitëse sipas pretendimit 1, ku mbështetësi i shtuar horizontal (2) ka priza (23) në të cilat janë vendosur rulat (22).

8. Kombinimi gjysmë i padukshëm i profileve termoizoluese të pjesës së poshtme të dyerve dhe dritareve rrëshqitëse sipas pretendimit 7, ku rulet (22) rregullohen me shtimin ose heqjen e ndarësve (29).
9. Kombinimi gjysmë i padukshëm i profileve termoizoluese të pjesës së poshtme të dyerve dhe dritareve rrëshqitëse sipas pretendimit 1, ku mbështetësi i shtuar horizontal (2) ka të paktën një rrotë (20a) që rrotullohet në boshtin vertikal (21) të vendosur në të paktën një zgavër (32).
10. Kombinimi gjysmë i padukshëm i profileve termoizoluese të pjesës së poshtme të dyerve dhe dritareve rrëshqitëse sipas pretendimit 3, ku profilet mbështetëse të aluminit (8a, 8b, 8c) kanë brazda lineare, gjatësore (10) në skajin e profileve.
11. Kombinimi gjysmë i padukshëm i profileve termoizoluese të pjesës së poshtme të dyerve dhe dritareve rrëshqitëse sipas pretendimit 7, ku një anë e sipërme e pjerrët e bazës mbështetëse (22a) të ruleve (22) bashkëpunon me suportin e shtuar horizontal (2) i cili gjithashtu anon (24) me të njëjtin kënd në pikën e tyre të kontaktit.
12. Kombinimi gjysmë i padukshëm i profileve termoizoluese të pjesës së poshtme të dyerve dhe dritareve rrëshqitëse sipas pretendimit 11, ku mbështetësja horizontale e shtuar ka dy prirje pasqyre (24) përgjatë gjatësisë së profilit të përmendur.
13. Kombinimi gjysmë i padukshëm i profileve termoizoluese të pjesës së poshtme të dyerve dhe dritareve rrëshqitëse sipas pretendimit 10, ku profilet mbështetëse të aluminit (8d, 8e, 8f) të përbërësve strukturorë të dyshemesë (12d, 12e, 12f) kanë shtrirje këndore në muret anësore të brazdës (25) (28a, 28b) dhe krijoni mure anësore prej alumini (25a).

(11) **11252**

(97) EP3672965 / 07/09/2022

(96) 18801171.2 / 26/10/2018

(22) 20/09/2022

(21) AL/P/ 2022/473

(54) **PËRBËRJE PRIMIDINE SI FRENUESE E JAK KINAZËS**

01/03/2023

(30) 201762577852 P 27/10/2017 US

(71) Theravance Biopharma R&D IP, LLC

901 Gateway Boulevard, South San Francisco, CA 94080, US


(72) DABROS, Marta (888 Foster City Boulevard Apt. Q2, Foster City California 94404); MCKINNELL, Robert Murray (321 Poplar Avenue, Millbrae California 94030); HUDSON, Ryan (1454 Walbrook Drive, San Jose California 95129); KOZAK, Jennifer (771 Prairie Creek Drive, Pacifica California 94044); BRANDT, Gary E.L. (2160 Buena Vista Avenue, Alameda California 94501) ;NZEREM, Jerry (29 Woods Circle, South San Francisco California 94080)

(74) KRENAR LOLOÇI

Rr. "Ibrahim Rugova", Pall. 1/1, Kati 2, Tiranë, Shqipëri

(57)


1. Një përbërje e formulës (I):



ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj.

2. Forma e lirë e përbërjes së pretendimit 1.

3. Një formë kristalore e përbërjes së formulës (I):



ku forma kristalore është karakterizuar nga një model difraksioni me rreze X pluhur që përfshin maja të difraksionit në vlera të 2θ prej 11.4 ± 0.2 , 16.2 ± 0.2 , 16.6 ± 0.2 , 17.7 ± 0.2 , dhe 21.9 ± 0.2 .

4. Forma kristalore e pretendimit 3, ku modeli i difraksionit me rreze X pluhur është më tej karakterizuar nga të paturit maja të difraksionit shtesë në vlera të 2θ prej 8.9 ± 0.2 , 9.5 ± 0.2 , dhe 10.2 ± 0.2 .

5. Forma kristalore e pretendimit 4, ku modeli i difraksionit me rreze X pluhur është më tej karakterizuar nga të paturit dy ose më shumë maja të difraksionit shtesë në vlera të 2θ të zgjedhura nga 14.4 ± 0.2 , 19.0 ± 0.2 , 19.2 ± 0.2 , 19.8 ± 0.2 , 20.1 ± 0.2 , 20.4 ± 0.2 , 20.6 ± 0.2 , 20.8 ± 0.2 , 21.3 ± 0.2 , 25.9 ± 0.2 , 30.1 ± 0.2 , 30.5 ± 0.2 , 30.9 ± 0.2 , 32.6 ± 0.2 , dhe 33.8 ± 0.2 .

6. Forma kristalore e pretendimit 3, ku forma kristalore është karakterizuar nga një gjurmë kalorimetrie skanuese diferenciale të regjistruar në një shkallë ngrohjeje prej $10\text{ }^\circ\text{C}$ në minutë e cila tregon një maksimum në rrjedhën endotermike të nxehtësisë me një majë në $238.1\text{ }^\circ\text{C} \pm 2\text{ }^\circ\text{C}$.

7. Një kompozim farmaceutik që përfshin një përbërje të çdo njërit prej pretendimeve 1 ose 2, dhe një mbartës farmaceutikisht të pranueshëm.

8. Një kompozim farmaceutik që përfshin një formë kristalore të çdo njërit prej pretendimeve 3 deri në 6, dhe një mbartës farmaceutikisht të pranueshëm.


9. Kompozimi farmaceutik i pretendimit 7 më tej që përfshin një ose më shumë agjentë terapeutik shtesë.

10. Kompozimi farmaceutik i pretendimit 7, ku kompozimi farmaceutik është një pomadë ose një krem.

11. Kompozimi farmaceutik i pretendimit 7, ku përbërja (I), ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj, është e pranishme në mes 0.1 dhe 10% nga pesha.


12. Kompozimi farmaceutik i pretendimit 7, ku përbërja (I), ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj, është e pranishme në mes 0.25 dhe 5% nga pesha.

13. Kompozimi farmaceutik i pretendimit 7, ku përbërja (I), ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj, është e pranishme në mes 0.05 dhe 0.5% nga pesha.
14. Një përbërje e pretendimit 1 ose 2, për përdorim në trajtimin e një sëmundje inflamatore ose autoimune të lëkurës në një gjitar.
15. Përbërja e pretendimit 14, për përdorim në trajtimin e sëmundje inflamatore të lëkurës në një gjitar.
16. Përbërja e pretendimit 15, për përdorim në trajtimin e dermatitit atopik.
17. Përbërja e pretendimit 16, ku dermatiti atopik është dermatit atopik i moderuar deri në i rëndë.
18. Përbërja e pretendimit 16, ku dermatiti atopik është dermatit atopik i lehtë deri në i moderuar.
19. Përbërja e pretendimit 14, për përdorim në trajtimin e alopecisë areata.
20. Përbërja e pretendimit 14, për përdorim në trajtimin e një sëmundje inflamatore ose autoimune të lëkurës të zgjedhur nga grupi i përbërë prej: vitiligos, prurigo nodularis, likenit planus, dermatitit me kontakt, manifestimeve të lëkurës të sëmundjes së organit të transplantuar ndaj bartësit, pemfigoid, lupusit diskoid, likenit skleroz, likenit planopilaris, psoriazës, dhe folikulitit dekalvans.
21. Përbërja e pretendimit 14, për përdorim në trajtimin e psoriazës.
22. Një proces për përgatitjen e një përbërje të formulës (I):



ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj, që përfshin:

(a) reagimin e një përbërje të formulës (II):




ku R është një grup C₁₋₁₂ alkil, me një agjent reduktues dhe

(b) opsionalisht duke formuar një kripë farmaceutikisht të pranueshme për të siguruar një përbërje të formulës (I), ose një kripë farmaceutikisht të pranueshme të saj.

23. Proçesi i pretendimit 22, ku agjenti reduktues është zgjedhur nga grupi i përbërë prej LiAlH₄, NaBH₄, dhe LiBH₄.


24. Proçesi i pretendimit 22, ku R është etil.

25. Proçesi i pretendimit 22, ku përbërja e formulës (II) është përftuar nga bashkimi i një përbërje të formulës (III)




(III)

ku X është një halogjen, me një përbërje të formulës 1-9



1-9

26. Një përbërje e formulës (II):




(II)

ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj,
ku R është një grup C₁₋₁₂ alkil.

27. Përbërja e pretendimit 26, ku R është etil.

28. Një përbërje e formulës (III):



(III)

ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj,
ku R është një grup C₁₋₁₂ alkil dhe X është halogjen.

29. Përbërja e pretendimit 28, ku R është etil dhe X është kloro.

(11) **11253**

(97) EP3705488 / 03/08/2022

(96) 20171670.1 / 29/05/2015

(22) 21/09/2022

(21) AL/P/ 2022/474

(54) **STEROIDË NEUROAKTIVE,KOMPOZIMET DHE PËRDORIMET E TYRE**

01/03/2023

(30) PCT/CN2014/078820 29/05/2014 WO

(71) Sage Therapeutics, Inc.

215 First Street, Cambridge, MA 02142, US


(72) SALITURO, Francesco G. (25 Baker Drive, Marlborough, MA 01752); BOTELLA, Gabriel Martinez (17 Parmenter Road, Wayland, MA 01778); HARRISON, Boyd L. (9 Wheatston Court, Princeton Junction, NJ 08550); ROBICHAUD, Albert Jean (2 Earhart Street 915, Cambridge, MA 02141); BERESIS, Richard Thomas (Apartment 2504, Building 1 199 Shimen 2 Road, Shanghai 200040)

(74) KRENAR LOLOÇI

Rr. "Ibrahim Rugova", Pall. 1/1, Kati 2, Tiranë, Shqipëri


(57)

1. Një përbërje e formulës:




për përdorim në një metodë për trajtimin e dridhjeve esenciale në një subjekt që ka nevojë për të, që përfshin administrimin e përbërjes te subjekti.

2. Përbërja për përdorim si në pretendimin 1, ku përbërja është administruar në mënyrë orale, subkutane, intravenoze ose intramuskulare.
3. Përbërja për përdorim si në pretendimin 1, ku përbërja është administruar në mënyrë kronike.
4. Përbërja për përdorim si në pretendimin 2, ku përbërja është administruar në mënyrë orale.
5. Përbërja për përdorim si në pretendimin 2, ku përbërja është administruar në mënyrë intravenoze.
6. Një kripë farmaceutikisht e pranueshme e një përbërjeje të formulës:



për përdorim në një metodë për trajtimin e dridhjes esenciale në një subjekt që ka nevojë për të, që përfshin administrimin te subjekti të kripës farmaceutikisht të pranueshme të përbërjes.

7. Kripa farmaceutikisht e pranueshme për përdorim si në pretendimin 6, ku kripa e pranueshme farmaceutikisht është administruar në mënyrë orale, subkutane, intravenoze ose intramuskulare.
8. Kripa farmaceutikisht e pranueshme për përdorim si në pretendimin 6, ku kripa farmaceutikisht e pranueshme është administruar në mënyrë kronike.
9. Kripa farmaceutikisht e pranueshme për përdorim si në pretendimin 7, ku kripa farmaceutikisht e pranueshme është administruar në mënyrë orale.
10. Kripa farmaceutikisht e pranueshme për përdorim si në pretendimin 7, ku kripa farmaceutikisht e pranueshme është administruar në mënyrë intravenoze.
11. Një kompozim farmaceutik që përfshin një përbërje të formulës:



dhe një ekscipient farmaceutikisht të pranueshëm për përdorim në një metodë për trajtimin e dridhjes esenciale në një subjekt që ka nevojë për të, që përfshin administrimin e kompozimit të subjekti.

12. Kompozimi farmaceutik për përdorim si në pretendimin 11, ku kompozimi farmaceutik është administruar në mënyrë orale, subkutane, intravenoze ose intramuskulare.

13. Kompozimi farmaceutik për përdorim si në pretendimin 11, ku kompozimi farmaceutik është administruar në mënyrë kronike.

14. Kompozimi farmaceutik për përdorim si në pretendimin 12, ku kompozimi farmaceutik është administruar në mënyrë orale.

15. Kompozimi farmaceutik për përdorim si në pretendimin 12, ku kompozimi farmaceutik është administruar në mënyrë intravenoze.

(11) **11254**

(97) EP3397568 / 20/07/2022

(96) 15823343.7 / 31/12/2015

(22) 21/09/2022

(21) AL/P/ 2022/475

(54) **ENË E PAJISUR ME MAJË SHTYTËSE QË HAP KAPAKUN I CILI PËRMBAN FILETIME TË SHUMTA**

02/03/2023

(30)

(71) Teamplast B.V.

Poort van midden Gelderland Rood 11, 6666 ZH Heteren, NL

(72) VERSLUIJS, Richard, Patrick (Witmolen 17, 2645 GE Delfgauw) ;VAN AMERONGEN, Gerard (Diedenweg 4, 6721 HR Bennekom)

(74) Ela SHOMO PANIDHA

EUROMARKPAT ALBANIA SH.P.K., Rruga A.Z. Çajupi, P .20/4, Ap.15

(57)

1. Një kapak (3) i cili siguron një hapësirë në kapak (6) për një aditiv dhe i cili ka:

- një hapje të hapësirës në kapak (7) të mbyllur nga një vulë (8) e cila mundet ose nuk mundet të jetë e para-dobësuar, dhe

- një majë shtytëse elastike (9) që ka mjete shtytëse (12) të cilat ndersa dëpërtojnë nëpërmjet hapësirës së kapakut (6) janë nga njëra anë të bashkuara tek maja elastike në njërin skaj (9), ndërkohë që skaji tjetër i mjeteve shtytëse të përmendura (12) drejtohet për nga hapja (7), maja shtytëse elastike (9) e cila ka një anë të sipërme (10) dhe një anë të poshtme të kundërt (11) sistemohet në mënyrë të tillë që pas shtytjes mjetet shtytëse (12) të cilat janë bashkuar në anën e poshtme (11) ruajnë pozicionet rrezore të fiksuara gjatë transferimit të tyre tek hapja (7), takohen me vulën (8) dhe shtyjnë përgjatë vulës (8), majën shtytëse elastike (9) duke pasur gjithashtu mjete shtrirëse (13) që zgjaten përgjatë hapësirës së kapakut (6) dhe të bashkuar në anën e poshtme (11) të majës shtytëse elastike (9), karakterizuar në atë që mjetet shtrirëse (13) janë sistemuar të ruajnë pozicionin e tyre rrezor kur mjetet shtytëse (12) shtyjnë përgjatë vulës (8) dhe hyjnë në veprim pasi vula (8) është shtyrë përpara, si përgjigje e një shtytjeje tjetër të majës shtytëse elastike (9), përkulet dhe shtrihet në mënyrë rrezore së jashtmi, ku, pas përkuljes dhe shtrirjes së mjeteve shtrirëse (13), pjesët e vulës të shtyra para (8-1, 8-2) shtrihen gjithashtu në mënyrë rrezore së jashtmi për të lejuar aditivin dhe substancën që të përzihen.

2. Kapaku (3) sipas pretendimit 1, i karakterizuar në atë që aditivi është një aditiv i tillë si një pudër, veçanërisht një pudër higroskopike, ose një lëng i tillë si pije, ose lëngje pastrimi, tretësa, bojëra e të tjera.
3. Kapaku (3) sipas pretendimit 1 ose 2, i karakterizuar në atë që kapaku (3) është i pajisur me një mjet të thyeshëm që tregon hapjen (18) ose me mjete që mbulojnë kapakun (20).
4. Kapaku (3) sipas secilit prej pretendimeve 1-3, i karakterizuar në atë që mjetet shtytëse (12) dhe mjetet shtrirëse (13) vendosen në një numër gjuhëzash gjatësore (16) të cilat zgjaten përgjatë hapësirës në kapak (6) që e ka hapjen e hapësirës së kapakut të saj (7) të mbyllur nga një vulë me material të para-dobësuar (8), dhe që maja shtytëse elastike (9) ka pjesë përkulëse të kontrollueshme (14-1, 14-2) të formuara për tu përkulur në vazhdimësi kur maja shtytëse elastike (9) shtyhet dhe shtyhet më tej, dhe që skajet e sipërme të gjuhëzave (16) janë bashkuar tek skajet e poshtme (11) të majës shtytëse elastike (9) në afërsi të pjesës përkulëse (14-2) e cila përkulet gjatë shtytjes së mëtejshme.
5. Kapaku (3) sipas secilit prej pretendimeve 1-4, i karakterizuar në atë që skajet e poshtme të gjuhëzave (16) formojnë mjetet shtytëse (12) dhe kreshtat anësore të gjuhëzave (16) formojnë mjetet shtrirëse (13).
6. Një enë për substancë (1) që ka një kapak (3) sipas pretendimit 1.
7. Ena (1) sipas pretendimit 6, e karakterizuar në atë që maja shtytëse elastike (9) ka pjesë përkulëse të kontrollueshme (14-1, 14-2) që janë formuar të përkulen në vazhdimësi kur maja shtytëse elastike (9) shtyhet dhe shtyhet në vijim, dhe që mjetet shtrirëse (13) janë bashkuar në afërsi të pjesës përkulëse (14-2) e cila përkulet gjatë shtytjes së mëtejshme.
8. Ena (1) sipas pretendimit 7, e karakterizuar në atë që pjesët përkulëse të kontrollueshme (14-1, 14-2) janë integruar në materialin e një koni elastik (15) që rrethon një buton që shtypet (19) të majës shtytëse elastike (9).
9. Ena (1) sipas pretendimit 7 ose 8, e karakterizuar në atë që pjesët përkulëse të kontrollueshme (14-1, 14-2) janë pjesë unazore të brendshme dhe të jashtme të ndara nga një pjesë unazore të ngurtë relativisht (15-1) ku mjetet shtrirëse (13) janë fiksuar në afërsi të pjesës përkulëse (14-2).

10. Ena (1) sipas secilit prej pretendimeve 7-9, e karakterizuar në atë që pjesët përkulëse të kontrollueshme (14-1, 14-2) janë mentesha me një ngurtësi të ndryshme reciproke në drejtimin ku maja shtytëse elastike (9) duhet të shtypet.
11. Ena (1) sipas secilit prej pretendimeve 6-10, e karakterizuar në atë që mjetet shtytëse (12) dhe mjetet shtrirëse (13) ndodhen të dyja në një numër gjuhëzash gjatësore (16) të cilat zgjaten përgjatë hapësirës në kapak (6) ku hapja (7) e hapësirës së kapakut të tyre mbyllet nga një vulë me material të paradobësuar (8) dhe të cilët në skajet e gjuhëzave të tyre të sipërme janë bashkuar në anën e poshtme të majës shtytëse elastike (9).
12. Konteineri (1) sipas pretendimit 11, i karakterizuar në atë që skajet e poshtme të gjuhëzave (16) formojnë mjetet shtytëse (12) dhe skajet anësore të gjuhëzave (16) formojnë mjetet shtrirëse (13).
13. Një metodë ku tek një substancë në një enë (1) sipas pretendimit 6 do të shtohet një aditiv i cili ndodhet në një hapësirë në kapak (6)

pas shtypjes së majës shtytëse elastike (9) mjetet shtytëse (12) të bashkuara në pjesën e poshtme të saj (11) ndërkohë që ruajnë pozicione rrezore të fiksuara përcillen për të kontaktuar dhe shtyrë përgjatë vulës (8) duke formuar pjesë vulosëse (8-1, 8-2), dhe pas shtytjes në vijim të majës shtytëse elastike (9) mjetet shtrirëse (13) që zgjaten përgjatë hapësirës së kapakut (6) dhe bashkohen tek pjesa e poshtme (11) hyjnë në veprim ku pjesët vulosëse (8-1, 8-2) shtrihen së jashtmi në mënyrë rrezore.

14. Metoda sipas pretendimit 13, e karakterizuar në atë që mjetet shtytëse (13) të cilat drejtohen për nga vula (8) fillimisht janë në një distancë (a) nga vula e pashtyrë (8).
15. Metoda sipas secilit prej pretendimeve 13-14, e karakterizuar në atë që pjesët vulosëse (8-1, 8-2) shtrihen deri në skajet (17) e hapjes (7) së kapakut (3).

(11) **11255**

(97) EP3701051 / 13/07/2022

(96) 19742381.7 / 24/07/2019

(22) 29/09/2022

(21) AL/P/ 2022/481

(54) **ZGJEDHJA DHE PËRDORIMI I BAKTEREVE MBËSHTETËSE TË MELATONINËS PËR REDUKTIMIN E KOLIKËS INFANTILE**

02/03/2023

(30) 201812079 24/07/2018 GB and 201905470 17/04/2019 GB

(71) Biogaia AB

Kungbroplan 3A P.O. Box 3242, 103 64 Stockholm, SE

(72) ROOS, Stefan (Västgötaresan 57, 757 54 Uppsala) ;MÖLLSTAM, Bo (Cederflychtsvägen 12, 443 31 Lerum)

(74) Krenar LOLOÇI

Rr. "Ibrahim Rugova", Pall. 1/1, Kati 2, Tiranë

(57)

1. Një shtam bakterial, ku shtami në fjalë është *Lactobacillus reuteri* DSM 32846, DSM 32847, DSM 32849 ose DSM 33198.

2. Shtami bakterial i pretendimit 1, ku shtami në fjalë është *Lactobacillus reuteri* DSM 32846.
3. Shtami bakterial i pretendimit 1, ku shtami në fjalë është *Lactobacillus reuteri* DSM 32847.
4. Shtami bakterial i pretendimit 1, ku shtami në fjalë është *Lactobacillus reuteri* DSM 32849.
5. Shtami bakterial i pretendimit 1, ku shtami në fjalë është *Lactobacillus reuteri* DSM 33198.
6. Shtami bakterial i cilitdo prej pretendimeve 1 deri 5 për përdorim në terapi.
7. Shtami bakterial i cilitdo prej pretendimeve 1 deri 5 për parandalimin e kolikës infantile te një subjekt.
8. Shtami për përdorim i pretendimit 7 ku subjekti është një foshnjë deri në 12-muajshe, preferohet deri në 6- ose 5-muajshe, ose preferohet deri në 3- ose 4-muajshe. dhe/ose ku subjekti ushqehet me gjë ose me qumësht formule, ose një kombinim të tyre.
9. Shtami për përdorim i pretendimit 7 ose 8, ku përdorimi në fjalë përfshin më tej administrimin e së paku një agjenti të mëtejshëm, ku agjenti i mëtejshëm në fjalë është AMP
10. Një metodë për përzgjedhjen e një shtami bakterial acidi laktik me aftësinë të formojë adenozinë, ku shtami në fjalë është *Lactobacillus reuteri* dhe ku metoda në fjalë përfshin:
 - a) kontrollin një shtami bakterial acidi laktik për praninë e një gjëni që kodon 5'-nukleotidaze, ku shtami në fjalë është *Lactobacillus reuteri*; dhe/ose
 - b) kontrollin një shtami bakterial acidi laktik ose të supernatantit të tij, për praninë e enzime 5'-nukleotidaze aktive, ku shtami në fjalë është *Lactobacillus reuteri*; dhe
